



UNIVERSITETI I SHKODRES

“Luigj Gurakuqi

N J O F T I M

Në mbështetje të V.K.M nr.911 dt.11.11.2015 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave dhe për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte për nxënësit e studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin akademik 2015-2016" urdhërit nr.474 dt.18.11.2015 "Për organizimin e punës në procesin e pranimit, shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave të studentëve për trajtim me bursë" njoftojmë se aplikimi për tu trajtuar me bursë për **vitet e dyta dhe të treta** do të bëhet **nga data 18 NENTOR 2015 deri më 28 NENTOR 2015 nga ORA 09.00 deri më 18.00, personalisht** nga studenti në Rektoratin e Universitetit **pranë Komisionit të Bursave** me dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për tu trajtuar me bursë.
2. Vërtetim të thjeshtë studentit.
3. Vërtetim nga qendra e banimit/rajoni përkatës
4. Deklaratë personale.
5. Certifikatë familjare e tre muajve të fundit (nuk pranohet certifikata e ndarjes nga trangu familjar sipas pikës 3/a të VKM).
6. Vërtetim për të ardhurat për të gjithë pjestarët e familjes sipas rastit pune/papunësie/pensionit (në rastet kur paraqitet vërtetimi i papunësisë duhet të jetë i plotë ku të përcaktohet punëkërkuës i papunë, trajtohet ose jo me pagesë papunësie ndërsa vërtetimet e punës/pensionit të kenë shprehimisht masën dhe numrin e dosjes).
7. Vërtetim i trajtimit me/pa ndihmë ekonomike (të cilësohet masa e ndihmës e plotë/e pjeshme dhe vlera e saj).
8. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore që nuk ushtron aktivitet privat për çdo pjestar të familjes veçmas duke përfshirë edhe vetë studentin.
9. Fotokopje e dokumentit të indentifikimit.
10. Nr.IBAN nga Raiffeisen Bank (të konfirmuar nga Banka)

Për rastet kur studentit bashkeshort me femije, duhet akomodohet në konvikte

Publike, ta paraqesë me vërtetim dhe plotësojë kriterin ekonomik, sipas pasqyres së VKM.

Sqarim për pjestarët e familjes deri në 14 vjeç vërtetim shkollë ndërsa 14-18 vjeç vërtetim shkollë ose Vërtetim pune/papunësie

Studentet e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë burse ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj, kur:

- a) janë ndarë nga trangu familjar;
- b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- d) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

Shënim1.Dokumentet duhet të jenë të plotë, origjinalë.(certifikata e tre muajve të fundit).

2.Deklarata personale pasi të përpilohet e të nënshkruhet nga studentit duhet edhe të fotokopjohet që studentit të marrë konfirmimin e dorëzimit të kërkesës nga specialisti ku i dorëzon ato. Firma origjinale e specialistit do të vendoset në deklaratë edhe në fotokopjen e saj.

Aplikimi fillon me 18 NENTOR 2015 deri më 28 NENTOR 2015 nga ORA 09.00 deri më 18.00.

Në mbështetje të shkresës nr.1709 dt.16.11.2015 të Prefektit të Qarkut Shkodër për marrje të planit të masave kundër akteve terroriste, do rritet kontrolli i hyrjes dhe daljes së studentëve ku do të përdoren forma dhe metoda për kontrollin fizik të tyre gjatë afatit të dorëzimit të aplikimit. Kur studentit të paraqitet në rektorat, te komisioni i bursave për dorëzimin e aplikimit duhet të jetë pa mjete si çanta, borseta, çadra, celular e objekte të tjera.Studentit duhet të jetë i gatshëm t'i nënshtrohet kontrollit fizik

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TE BURSAVE